



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 6, datë 10.07.2020

“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Pika 41 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“41. Bisedimet e çështjes, si edhe votimi i vendimit bëhen vetëm nga anëtarët e Këshillit. Avokati i Popullit merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në funksion të transparencës dhe besimit të publikut.”.

Neni 2

Në pikën 43 shprehja “i pasuar nga Kryetari” shfuqizohet, si dhe shtohet fjalia me përmbajtjen si vijon:

“Kryetari i Këshillit voton i fundit.”.

Neni 3

Në pikën 104, shprehja “e dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit” zëvendësohet me shprehjen “përfundimtar të rivlerësimit kalimtar”.

Neni 4

Në pikën 105, pas fjalës “detyrë” shtohet shprehja “me vendim përfundimtar”.

Neni 5

Në pikën 112, shprehja “Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të ketë dhënë vendim” zëvendësohet me shprehjen “organet e rivlerësimit të kenë dhënë vendim përfundimtar”.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE

Vitore Tusha